



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E KOORDINIMIT TË SKS, PËRAFRIMIT DHE PROJEKTEVE
Sektori i Koordinimit dhe Planifikimit Strategjik

Raporti 4-mujor i monitorimit të Programit të Statistikave Zyrtare¹

(Janar-Prill, 2024)

¹ Ky raport hartohet në zbatim të Nenit 17, pika 5 të Ligjit nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”. Në mbështetje në nenit 17, pika 5 e Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT ka përgjegjësinë për t’i paraqitur Këshillit të Statistikave raporte të shkurtra 4-mujore për ecurinë e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare.

INSTAT - Instituti i Statistikave

Tel+(355) 4 2222411
+(355) 4 2233356
Fax+(355) 4 2228300

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H. 1, Nj.A. Nr.2, 1017,
Tiranë, Shqipëri

info@instat.gov.al



Tabela e Përmbajtjes

Hyrje.....	3
Treguesit e performancës së SKS në zbatim të objektivave zhvillimorë 2022-2026.....	4
Zbatimi i PSZ për periudhën Janar-Prill, 2024.....	5
Fusha statistikore 1: Statistikat Demografike dhe Sociale	7
Fusha statistikore 2: Statistikat Ekonomike	12
Fusha statistikore 3: Statistikat Sektoriale	18
Fusha statistikore 4: Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain.....	28
Menaxhimi i Cilësisë.....	31
Analiza e risqeve.....	32
Regjistrat e biznesit.....	33



Hyrje

Programi i Statistikave Zyrtare është dokumenti bazë që parashikon prodhimin e statistikave zyrtare nga Sistemi Kombëtar Statistikor të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë. Monitorimi i ecurisë së programit është element shumë i rëndësishëm për garantimin e plotësimit të aktiviteteve statistikore të parashikuara në të.

Ligji nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” parashikon si një ndër instrumentet monitoruese raportimin periodik me bazë 4-mujore.

Raporti 4 - mujor mbi zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare (PSZ) për periudhën Janar-Prill, 2024, është përgatitur në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore, të cilat kanë dhënë informacion për modulet statistikore nën përgjegjësinë e tyre sipas programit. Ky raport i referohet zbatimit të Planit Vjetor të PSZ për vitin 2024, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendim nr. 15/2024, datë 08.02.2024 “Për miratimin e Planit Vjetor 2024 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”, në zbatim të së cilit Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore merr statusin ‘Agjenci Statistikore’. Ky status, veç të tjerash, ngarkon AKBN me detyrimin për raportim me frekuencë 4-mujore mbi zbatimin e aktiviteteve statistikore për të cilat është përgjegjës. Në këtë kontekst, risi i këtij raporti është përfshirja e AKBN si agjenci raportuese. Raporti përmban në strukturën e tij një informacion të shkurtër mbi ecurinë 4 - mujore të treguesve strategjikë si matës afatshkurtër të ecurisë së Sistemit Kombëtar Statistikor në drejtim të zbatimit të objektivave strategjikë 2022-2026, një informacion të detajuar të ecurisë së aktiviteteve statistikore të planifikuara për secilën fushë për 4-mujorin referencë, si dhe informacion mbi tregesuit kryesor të cilësisë statistikore për këtë periudhë. Ecuria e aktiviteteve statistikore monitorohet nëpërmjet raportimit të zbatimit të afateve të katër fazave kryesore të prodhimit statistikor: grumbullimi, përpunimi, publikimi i të dhënave, si dhe transmetimi i tyre në Eurostat. Gjithashtu, për çdo aktivitet përcaktohet niveli i detajimit të të dhënave sa i përket disagregimit (mikro, makro) si dhe niveli gjeografik i tyre. Gjithashtu, për çdo aktivitet jepet dhe niveli i përputhshmërisë me standardet e Eurostatit, raportim i cili bazohet në vlerësimin e fundit sipas SMIS+. Për çdo fushë statistikore raportohen edhe aktivitetet statistikore për të cilat të dhënat nuk janë grumbulluar, përpunuar apo publikuar në kohë, shoqëruar me arsyen e moszbatimit të afateve. Pjesë e raportimit janë dhe aktivitetet statistikore nga të cilat nuk prodhohen të dhëna statistikore si dhe aktivitetet e perealizuara gjatë periudhës së raportimit.

Raportet 4 - mujore për zbatimin e PSZ janë dokumentet bazë të cilat paraqiten nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT për Këshillin e Statistikave dhe shërbejnë për hartimin e Raportit Vjetor, i cili i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë.



Progres-Raporti Janar-Prill, 2024

Gjatë periudhës Janar-Prill, 2024, agjencitë statistikore si: INSTAT, Banka e Shqipërisë Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore janë angazhuar për realizimin e aktiviteteve statistikore që kanë nën përgjegjësi sipas Planit Vjetor 2024 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 – 2026.

Treguesit e performancës së SKS në zbatim të objektivave zhvillimorë 2022-2026

Duke qenë se në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026 janë përfshirë objektivat zhvillimorë strategjikë, Sistemit Kombëtar Statistikor i lind detyrimi i raportimit në nivel 4 mujor mbi aktivitetet e kryera në drejtim të këtyre objektivave, performanca e të cilëve matet nëpërmjet treguesve respektivë.

Më poshtë paraqitet tabela me vlerat e treguesve për periudhën Janar-Prill, 2024, në një qasje krahasimore me vlerat e pritshme për vitin 2024.

Ecuria 4 mujore e treguesve strategjikë Janar-Prill, 2024

Objektivi	Treguesi	Vlera për periudhën Janar-Prill, 2024	Target line 2024
Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i SKS për të përmbushur plotësisht acquis communautaire lidhur me statistikat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integritetit Evropian	1.2 Numri i akteve të reja ligjore të përafuara me acquis (Sipas PKIE)	0	0
	1.3 Rekomandime të Eurostatit (nga raporti <i>Peer Review 2018</i>), të zbatuara (në %)	Realizuar në masën 100% gjatë vitit 2023	100%
Objektivi strategjik 2: Plotësimi i nivelit të plotë të kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare	2.2 Numri i vizitave në faqen e internetit të INSTAT-it	- ²	+10% nga viti i kaluar (në 2023 nr. i klikimeve ishte: 3.020.981)
	2.6 Numri i aktiviteteve statistikore të disagreguara në nivel minimal vendor	1	11
Objektivi strategjik 3:	3.2 Numri i raporteve të	19	43

² Vlera e këtij indikatori nuk mund të gjenerohet për periudhën reference për dy arsye:

1. Sulmi kibernetik: për shkak të sulmit gjatë periudhës Shkurt-Prill 2024 aksesi në faqen e INSTAT ka qenë me orar të kufizuar, nga ora 08:00-17:30, dhe për këtë arsye nuk mund të sigurohet krahasueshmëria me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
2. Ndryshimi i platformës së google analytics: INSTAT po synon të kalojë në një platformë të ndryshme nga google analytics, në një platformë më të sigurt dhe do të migrojë të dhënat pasi të marrë licencën e kësaj platforme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranuar Evropiane dhe ndërkombëtare	cilësisë të publikuara		
Objektivi strategjik 4: Përfshirja e institucioneve shtesë prodhues në Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare	4.2 Numri i institucioneve furnizuese me të dhëna administrative mikro	3	4
	4.3 Numri i temave të trajnimeve të organizuara nga INSTAT	Nuk ishin planifikuar trajnime për periudhën referencë	13
Objektivi strategjik 5: Modernizimi i mëtejshëm i proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efikasitetin në kosto të statistikave zyrtare	5.3 Numri i aktiviteteve statistikore tek të cilat përdoren software	61	104
Objektivi strategjik 6: Rritja e besimit të publikut në SKS dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur	6.2 Numri i referimeve ndaj produkteve të SKS-së në media, p.sh., në gazetatat ditore kryesore ose në televizione	9611	3000

Zbatimi i PSZ për periudhën Janar-Prill, 2024

Për periudhën Janar-Prill, 2024, janë parashikuar 61 aktivitete për prodhimin e 56 produkteve statistikore, ndërkohë janë realizuar 54 produkte statistikore.

Ndarja e aktiviteteve dhe produkteve statistikore sipas agjencive statistikore rezulton të jetë:

INSTAT: përgjegjës për 53 aktivitete statistikore për publikimin e 43 produkteve statistikore - ka realizuar 41 publikime

Banka e Shqipërisë: përgjegjës për 6 aktivitete statistikore për publikimin e 12 produkteve statistikore - ka realizuar 12 publikime

Ministria e Financave: përgjegjës për 1 aktivitet statistikor për publikimin e 1 produkti statistikor - ka realizuar 1 publikim.



Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore: përgjegjës për 1 aktivitet statistikor – nuk ka planifikuar publikim për këtë periudhë.

Rezultatet për 4-mujorin referencë, sipas fazave të prodhimit statistikor, janë si më poshtë:

- *Grumbullimi i të dhënave:*
 - Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 110 produkte statistikore
 - Grumbulluar të dhënat në kohë për 105 produkte statistikore
 - 45 vrojtime: 37 PAPI; 7 CAPI; 1 CATI
 - 43 burime administrative: 9 mikro; 31 makro; 3 kombinuar (mikro+makro)
 - 6 burime të kombinuara: 1 mikro; 4 makro; 1 kombinuar (mikro+makro);
 - 11 burime të tipit “tjetër” (burime administrative+regjistra+databaza): 11 kombinuar (mikro+makro).
 - Nuk janë grumbulluar të dhënat në kohë për 5 produkte statistikore.
- *Përpunimi i të dhënave:*
 - Planifikuar përpunimi i të dhënave për 86 produkte statistikore;
 - Përpunuar të dhënat në kohë për 84 produkte statistikore;
 - Nuk janë përpunuar të dhënat në kohë për 2 produkte statistikore.
- *Publikimi i të dhënave*
 - Planifikuar realizimi i 56 publikimeve statistikore;
 - Realizuar 54 publikime statistikore;
 - Nuk janë realizuar në kohë 2 publikime statistikore.
- *Niveli minimal gjeografik i të dhënave të publikuara:*
 - Për 39 produkte statistikore të dhënat janë në nivel kombëtar;
 - Për 4 produkte statistikore të dhënat janë në nivel rajoni;
 - Për 10 produkte statistikor të dhënat janë në nivel qarku;
 - Për 1 produkt statistikor të dhënat janë në nivel bashkie;
- *Transmetimi i të dhënave në Eurostat*
 - Janë transmetuar të dhënat për 34 produkte statistikore

Përsa i përket nivelit të përputhshmërisë me Eurostat rezultojnë:

- 1 produkt plotësisht në përputhje
- 7 produkte me nivel të lartë përputhshmërie;
- 21 produkte me nivel të mesëm përputhshmërie;
- 14 produkte me nivel të ulët përputhshmërie;
- 1 produkt i papërputhshëm
- 10 produkte të pavlerësuar



Më poshtë paraqitet në mënyrë të detajuar ecuria e realizimit të aktiviteteve statistikore për secilën fushë statistikore sipas 4 fazave: grumbullim, përpunim, publikim, transmetim të dhënash.

Fusha statistikore 1: Statistikat Demografike dhe Sociale

Statistikat sociale përfshijnë një sërë fushash që lidhen me statistikën e popullsisë, tregut të punës dhe pagave, arsimin, shëndetësisë, të ardhurave dhe shpenzimeve të konsumit, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe krimit, kulturës, si dhe përdorimit të kohës.

- Objektivi kryesor i statistikave sociale është që të sigurojë të dhëna në kohë dhe me cilësi të lartë të treguesve statistikore, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave sociale dhe ekonomike me qëllimin final të zhvillimit dhe përmirësimit të mirëqënies shoqërore, si dhe në monitorimin e impaktit të këtyre politikave në aspektet e ndryshme të jetës në vend.

Agjencia statistikore përgjegjëse: INSTAT

Për periudhën Janar-Prill, 2024, në këtë fushë statistikore janë 12 aktivitete që kanë të planifikuar mbylljen e të paktën një prej fazave të prodhimit statistikor.

Gjatë kësaj periudhe është planifikuar realizimi i publikimit të 9 produkteve statistikore, nga të cilat janë realizoj 7 publikime statistikore.

*Numri i produkteve statistikore që janë listuar në fazat e mëposhtme (grumbullim / përpunim / publikim / transmetim) është i ndryshëm sepse 1 aktivitet statistikor mund të ketë në këtë periudhë mbyllje të 1,2,3 ose 4 fazave të prodhimit statistikor.


1. Grumbullimi i të dhënave:

- **Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 15 produkte statistikore**
- **Grumbulluar të dhënat në kohë për prodhimin e 13 produkteve të mëposhtme statistikore:**
 2. Statistikat Vitale, T4 - 2023
 3. Statistikat Vitale, T1 - 2024
 4. Statistika të forcave të punës, T4 - 2023
 5. Statistika të tregut të punës, T4 - 2023
 6. Statistika të diplomimeve në arsim
 7. Statistikat mbi shkaqet e vdekjeve
 8. Statistika nga Anketa e Buxhetit të Familjes, për vitin 2023
 9. Statistika mbi ndihmën ekonomike, K4, 2023
 10. Statistika të Aftësisë së kufizuar, K4, 2023
 11. Statistika të Pagesës së papunësisë, për T4, 2023
 12. Statistika të kriminalitetit, veprave penale, procedimeve penale
 13. Statistika të personave të dyshuar, të pandehur dhe të burgosur

- Për 2 produkte statistikore të dhënat janë grumbulluar me anë të vrojtimit, duke përdorur për 1 produkt metodën CATI dhe për produktin tjetër metodën PAPI.
- Për 11 produkte statistikore të dhënat janë marrë nga burime administrative, ku për 4 produkte të dhënat janë të nivelit mikro, ndërsa për 7 produkte të dhënat janë të nivelit makro.

- **Të dhënat nuk janë grumbulluar në kohë për 2 produktet e mëposhtme:**
 - Statistikat e Regjistrimeve në Arsim
Arsyeja e moszbatimit të afatit: Vonesa e dërgimit të të dhënave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
 - Statistika të arsimit sipas fushave të studimit në arsimin e lartë
Arsyeja e moszbatimit të afatit: Vonesa e dërgimit të të dhënave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Grafiku 1.1 Përmbledhja e fazës së grumbullimit për fushën: Statistikat Demografike dhe Sociale



2. Përpunimi i të dhënave

- **Planifikuar për tu përpunuar të dhënat për 14 produkte statistikore**
- **Përpunuar të dhënat në kohë për prodhimin e 12 produkteve statistikore të mëposhtme:**


1. Statistikat Vitale, T4 - 2023
2. Statistikat Vitale, T1 - 2024
3. Statistika të Forcave të Punës, T4 - 2023
4. Statistika të Tregut të Punës, T4 - 2023
5. Statistikat mbi Pagat, T4 - 2023
6. Statistika nga Anketa e Strukturës së Ardhurave nga Puna

7. Statistika nga Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2022
8. Ndihma ekonomike, K4, 2023
9. Statistika të Aftësisë së kufizuar, K3, 2023
10. Statistika të Pagesës së papunësisë, për T4, 2023
11. Statistika të kriminalitetit, veprave penale, procedimeve penale
12. Statistika të personave të dyshuar, të pandehur dhe të burgosur

➤ **Nuk janë përpunuar të dhënat në kohë për 2 produktet e mëposhtme:**

- Statistikat e Regjistrimeve në Arsim
Arsyeja e moszbatimit të afatit: Vonesa e dërgimit të të dhënave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit solli dhe vonesë në përpunimin e të dhënave.
- Statistika të arsimit sipas fushave të studimit në arsimin e lartë
Arsyeja e moszbatimit të afatit: Vonesa e dërgimit të të dhënave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit solli dhe vonesë në përpunimin e të dhënave.

Grafiku 1.2 Përmbledhja e fazës së përpunimit për fushën: Statistikat Demografike dhe Sociale



3. Publikimi i të dhënave

- **Planifikuar publikimi i të dhënave për 9 produkte statistikore**
- **Realizuar në kohë publikimi (njoftimi për shtyp, tabela e përditësuar, databaza e përditësuar) për 7 produktet statistikore të mëposhtme:**


1. Treguesit Demografikë, T4 - 2023
2. Anketa Tremujore e Forcave të Punës, T4 - 2023
3. Të dhëna administrative të tregut të punës T4 - 2023
4. Statistikat e Pagave T4 -2023
5. Anketa e Strukturës së Ardhurave nga Puna
6. Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2022
7. Krimet dhe Drejtësia Penale

- Për 5 produkte statistikore niveli minimal i të dhënave është niveli kombëtar
- Për 2 produkte statistikore niveli minimal i të dhënave është qarku

➤ **Të dhënat nuk janë publikuar në kohë për 2 produktet e mëposhtme:**

- Statistikat e Regjistrimeve në Arsim
Arsyeja e moszbatimit të afatit: Vonesa e dërgimit të të dhënave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit solli dhe vonesë në përpunimin dhe publikimin e të dhënave.
- Statistika të arsimit sipas fushave të studimit në arsimin e lartë
Arsyeja e moszbatimit të afatit: Vonesa e dërgimit të të dhënave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit solli dhe vonesë në përpunimin dhe publikimin e të dhënave.

Grafiku 1.3 Përmbledhja e fazës së publikimit për fushën: Statistikat Demografike dhe Sociale




4. Transmetimi

-Nuk është planifikuar transmetim të dhënash për këtë periudhë.

➤ **Niveli i përputhshmërisë me acquis për produktet e publikuara:**

- 1 produkt plotësisht në përputhje
- 1 produkt me nivel të lartë përputhshmërie
- 3 produkte me nivel të mesëm përputhshmërie
- 1 produkt i papërputhshëm
- 1 produkt i pavlerësuar

1.4. Grafiku i nivelit të përputhshmërisë me acquis për fushën: Statistikat Demografike dhe Sociale



➤ Aktivitetet në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023

Gjatë periudhës Janar-Prill, 2024, aktivitetet e kryera në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 janë si më poshtë:

- Vijnë puna për pastrimin, përpunimin, dhe inputimin e të dhënave të Censit, së bashku me raportet e vlerësimit të cilësisë së të dhënave të Censit, si dhe për përditësimin e kornizës që garanton sigurinë dhe cilësinë e Censit duke përshtatur dhe modifikuar proceset sipas nevojës.
- Për realizimin e aktiviteteve të planifikuara dhe për të mbështetur INSTAT me asistencë teknike janë kryer disa misione me ekspertë mbi tabulimet e rezultateve të Censit dhe APC. Aktivitetet e tabulimit u fokusuan në:
 - validimin e të dhënave, përpunimin e të dhënave dhe strategjinë mbi ndërtimin e bërthamave të familjeve;
 - ndërtimin e sintaksave për tabelat; testimin e skripteve në 'file'-in e banesave, NJEF dhe individëve;
 - analizimin dhe derivimin e variablave të derivuar lidhur me planin e tabulimeve;
 - analizimin e bërthamave të gjeneruara automatikisht nga strategjia dhe derivimin e bërthamave në tipologji komplekse NJEF manualisht.
 - Hartimin e draft-formatit të publikimit dhe rezultateve.
- Zhvillimi i procedurave në R për të lidhur dhe përputhur të dhënat e individëve dhe NJEF-ve të APC me ato të Censit, nga databazat përkatëse, si dhe zbatimi i procedurave të përputhshmërisë për të lidhur të dhënat e APC dhe Censit për kampionin e ZC-ve të ri-numëruara.

- Përsa i përket teknologjisë së informacionit, gjatë kësaj periudhe aktivitetet e realizuara lidhen me:
 - Bashkimin e dataseve bazuar në klasifikimet për kodimin ISCO-08 dhe NACE rev.2 dhe përgatitjen e të dhënave për kodimin ISCED.
 - Kontrollin e të dhënave për të kontrolluar dhe ruajtur integritetin e tyre.
 - Eliminimin sistematik të duplikateve brenda familjeve dhe në nivel kombëtar, për të rritur pastërtinë e të dhënave.
 - Validimin me përpikmëri të rregullave të editimit (Edit Rules) për të siguruar saktësinë e të dhënave.
 - Realizimin e procedurave të editimit dhe imputimit të të dhënave për të adresuar mospërputhjet.
- Gjithashtu INSTAT gjatë kësaj periudhe ka punuar për hartimin dhe implementimin e strategjisë së publikimit të të dhënave gjeohapësinore dhe ndërtimin e gjeoportalit të ri të INSTAT-it. Gjithashtu, njësia është angazhuar në kontrollin e të dhënave të ardhura nga terreni në lidhje me përditësimin e zonave të censit. Për kryerjen e aktiviteve, puna është bashkërenduar me mbështetjen e asistencës teknike në kuadër të Censit.
- Gjatë kësaj periudhe janë kryer dy misione të asistencës teknike me objektiv përgatitjen e një draft strategjie për publikimin e të dhënave gjeohapësinore dhe përcaktimin e hapave konkretë në implementimin e saj.
- Lidhur me implementimin e strategjisë dhe gjeoportalit të ri të INSTAT-it gjatë kësaj periudhe ka nisur implementimi praktik i ndërtimit të gjeoportalit të ri. Ka vijuar puna për përgatitjen e të dhënave tabelare, ndërtimin e gjeodatabazës së gjeoportalit dhe implementimin e komponentit IT të gjeoportalit.
- Përsa i përket kontrollit të të dhënave nga përditësimi i hartave në terren gjatë kësaj periudhe janë shkarkuar të dhënat e ardhura nga përditësimi i hartave në terren gjatë Censit, si dhe janë siguruar dhe të dhënat nga Censi i Popullsisë dhe Banesave që do të përpunohen gjatë periudhës Maj-Shtator 2024.

Fusha statistikore 2: Statistikat Ekonomike

Statistikat ekonomike përfshijnë fushat si: statistikat makroekonomike, statistikat financiare të qeverisë, fiskale dhe sektorit publik dhe statistikat e biznesit, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave ekonomike dhe përbëjnë bazën kryesore të



informacionit për analiza të mëtejshme mbi zhvillimin dhe ndryshimet strukturore të ekonomisë së vendit.

- Qëllimi kryesor i statistikave ekonomike është që të sigurojnë të dhëna në kohë dhe me cilësi të lartë të treguesve statistikorë, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave ekonomike si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e këtyre fushave.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave.

Për periudhën Janar-Prill, 2024, për këtë fushë statistikore janë planifikuar 16 aktivitete statistikore që kanë mbylljen e të paktën një prej fazave të prodhimit statistikor.

Gjatë kësaj periudhe është planifikuar publikimi i 10 produkteve statistikore dhe është realizuar publikimi për 10 produktet e planifikuara.

Aktivitetet dhe publikimet e planifikuara/realizuara sipas agjencive janë si më poshtë:

- INSTAT është përgjegjës për 14 aktivitete statistikore - planifikuar 5 produkte - realizuar 8 publikime statistikore
- Banka e Shqipërisë është përgjegjës për 1 aktivitet statistikore - planifikuar 4 produkte - realizuar 4 publikime statistikore
- Ministria e Financave është përgjegjës për 1 aktivitet statistikor - planifikuar 1 produkt - realizuar 1 publikim statistikor

*Numri i produkteve statistikore që janë listuar në fazat e mëposhtme (grumbullim / përpunim / publikim / transmetim) është i ndryshëm sepse 1 aktivitet statistikor mund të ketë në këtë periudhë mbyllje të 1,2,3 ose 4 fazave të prodhimit statistikor.

1. Grumbullimi i të dhënave

- **Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 21 produkte statistikore**
- **Grumbulluar të dhënat në kohë për prodhimin e 18 produkteve statistikore të mëposhtme:**
 1. Llogaritë jo-financiare sipas sektorëve institucional
 2. Llogaritë kombëtare tremujore-Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve, për T4, 2023
 3. Tabelat Burim - Përdorime
 4. Llogaritë rajonale
 5. Statistikat Financiare të Qeverisë sipas ESA2010
 6. Statistikat e Procedures së Deficitit të Tejkualuar, për 6 mujorin e pare, 2024
 7. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M12, 2023
 8. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M1, 2024
 9. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M2, 2024
 10. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M3, 2024



11. Statistikat e borxhit të sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhit të garantuar, për T1, 2024
12. Statistikat e produkteve industrial
13. Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve, për T4, 2023
14. Statistikat e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike në nivel tremujor, për T4, 2023
15. Statistikat e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike në nivel tremujor, për T1, 2024
16. Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, për T4, 2023
17. Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, për T1, 2024
18. Regjistri i Grupeve të Ndërmarrjeve

-Për 3 produkte statistikore të dhënat janë grumbulluar me anë të vrojtimeve, ku për 2 produkte është përdorur metoda PAPI, ndërsa për 1 produkt është përdorur metoda CAPI.

-Për 6 produkte statistikore të dhënat janë marrë nga burimi administrativ, ku për 1 produkt të dhënat janë mikro, për 3 produkte të dhënat janë makro, ndërsa për 2 produkte të tjera të dhënat janë të kombinuara (makro+mikro).


-Për 5 produkte statistikore të dhënat janë marrë nga burime të kombinuara (Vrojtım+Burım administrativ) ku të dhënat për 1 produkt janë mikro, ndërsa për 4 produkte të dhënat janë të kombinuara (Mikro+Makro).

-Për 4 produkte burimi i të dhënave është i tipit “Tjetër”, ku të dhënat merren nga burime administrative, regjistra, databaza dhe të dhënat janë mikro.

➤ **Të dhënat nuk janë grumbulluar në kohë për 3 produktet e mëposhtme:**

- Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve, për T4, 2023
Arsyeja e moszbatimit të afatit: Mungesa e të dhënave administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
- Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve
Arsyeja e moszbatimit të afatit: Mungesa e skedarit të tatim-fitimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
- Regjistri i Njësive Lokale
Arsyeja e moszbatimit të afatit: Mungesa e skedarit të tatim-fitimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.


Grafiku 2.1 Përmbledhja e fazës së grumbullimit për fushën: Statistikat Ekonomike



2. Përpunimi i të dhënave

- **Planifikuar përpunimi i të dhënave për 12 produkte statistikore**
- **Përpunuar të dhënat në kohë për prodhimin e 12 produkteve statistikore të mëposhtme:**
- 1. Llogaritë kombëtare tremujore - Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve, T4, 2023
 2. Statistikat Financiare të Qeverisë sipas ESA2010
 3. Statistikat e Procedures së Deficitit të Tejkualuar, për 6 mujorin e pare, 2024
 4. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M12, 2023
 5. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M1, 2024
 6. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M2, 2024
 7. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M3, 2024
 8. Statistikat e borxhit të sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhit të garantuar, për T1, 2024
 9. Statistikat strukturore të ndërmarrjeve
 10. Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve, për T4, 2023
 11. Statistikat e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike në nivel tremujor, per T4, 2023
 12. Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, për T4, 2023


Grafiku 2.2 Përmbledhja e fazës së përpunimit për fushën: Statistikat Ekonomike



3. Publikimi i të dhënave

- **Planifikuar për tu publikuar të dhënat për 10 produkte statistikore**
- **Realizuar në kohë publikimi (njoftimi për shtyp, tabela e përditësuar, databaza e përditësuar) për 10 produktet statistikore të mëposhtme:**
- 1. Produkti i Brendshëm Bruto, T4-2023
 2. Statistikat monetare (për M12, 2023)
 3. Statistikat monetare (për M1, 2024)
 4. Statistikat monetare (për M2, 2024)
 5. Statistikat monetare (për M3, 2024)
 6. Buletini i Treguesve të Borxhit (për T1, 2024)
 7. Rezultatet finale të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, 2021
 8. Statistikat Afatshkurtra: Prodhuesit e të mirave, T4 - 2023; Shërbimet, T4 - 2023; Tregtia me Pakicë, T4 - 2023
 9. Indeksi i Çmimeve të Prodhimit, Indeksi i Çmimeve të Importit, Indeksi i Kushtimit në Ndërtim, T4 - 2023
 10. Lejet e Ndërtimit, T4 - 2023
 - Për 7 produkte statistikore niveli minimal i të dhënave është niveli kombëtar
 - Për 2 produkte statistikore niveli minimal i të dhënave është qarku
 - Për 1 produkt statistikore niveli minimal i të dhënave është bashkia

Grafiku 2.3 Përmbledhja e fazës së publikimit për fushën: Statistikat Ekonomike




4. Transmetimi

- **Janë transmetuar në Eurostat të dhënat për 6 produktet e mëposhtme:**
 1. Produkti i Brendshëm Bruto, T4 - 2023
 2. Statistikat Financiare të Qeverisë sipas ESA2010
 3. Statistikat e Procedures së Deficitit të Tejkualuar, për 6 mujorin e pare, 2024
 4. Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve, për T4, 2023
 5. Statistikat e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike në nivel tremujor, per T4, 2023
 6. Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, për T4, 2023
- **Niveli i përputhshmërisë me acquis për produktet e publikuara është:**
 - 5 produkte me nivel të lartë përputhshmërie
 - 2 produkte me nivel të mesëm përputhshmërie
 - 2 produkte me nivel të ulët përputhshmërie
 - 1 produkt i pavlerësuar

Grafiku 2.4 Përmbledhja e fazës së transmetimit për fushën: Statistikat Ekonomike

2. Statistikat ekonomike



Fusha statistikore 3: Statistikat Sektoriale

Statistikat sektoriale përfshijnë një sërë fushash heterogjene si: statistikat e bujqësisë, peshkimit dhe pyjeve, statistikat e energjisë, transportit, turizmit, statistikat mbi tregtinë e jashtme dhe bilancin e pagesave, statistikat e çmimeve, shkencës dhe teknologjisë, inovacionit.

- Objektivi kryesor i statistikave sektoriale është që të sigurojnë të dhëna në kohë me cilësi të lartë të treguesve statistikore, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave të përbashkëta mbi fushat e sipërpërmendura si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e tyre.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë

Për periudhën Janar-Prill, 2024, për këtë fushë statistikore, janë planifikuar 28 aktivitete statistikore që kanë mbylljen e të paktën një prej fazave të prodhimit statistikor.

Gjatë kësaj periudhe është planifikuar publikimi i 35 produkteve statistikore dhe është realizuar publikimi për të gjitha produktet sipas planit.

Aktivitetet dhe publikimet e planifikuara/realizuara sipas agjencive rezultojnë si më poshtë:

- INSTAT është përgjegjës për 22 aktivitete – planifikuar 27 produkte – realizuar 27 publikime statistikore
- Banka e Shqipërisë është përgjegjës për 5 aktivitete – planifikuar 8 produkte – realizuar 8 publikime statistikore
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore – përgjegjës për 1 aktivitet - nuk ka planifikuar publikim gjatë kësaj periudhe



*Numri i produkteve statistikore që janë listuar në fazat e mëposhtme (grumbullim / përpunim / publikim / transmetim) është i ndryshëm sepse 1 aktivitet statistikor mund të ketë në këtë periudhë mbyllje të 1,2,3 ose 4 fazave të prodhimit statistikor.

1. Grumbullimi i të dhënave


- **Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 69 produkte statistikore**
- **Grumbulluar të dhënat në kohë për prodhimin e 69 produkteve statistikore të mëposhtme:**
 1. Statistikat e pyjeve
 2. Statistikat e produkteve bimore të gjeneruara nga burimi administrativ
 3. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vërtetimi vjetor në bujqësi
 4. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vërtetimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta, për M12, 2023
 5. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vërtetimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta, për M1, 2024
 6. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vërtetimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta, për M2, 2024
 7. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vërtetimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta, për M3, 2024
 8. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vërtetimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve të shpendëve, për M12, 2023
 9. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vërtetimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve të shpendëve, për M1, 2024
